



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 qershor 2019
Nr. ref.:RK 1383/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI67/18

Parashtrues

Arbenita Arifi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit për shpallje të faljes, të
Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DF-02-2018, të 10 prillit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arbenita Arifi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Dekretin për shpallje të faljes, të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DF-02-2018, të 10 prillit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), duke mos specifikuar se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 31 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 7 maj 2018, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 10 maj 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 14 maj 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Latifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues.
12. Më 10 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.

13. Më 12 shtator 2018, Gjykata njoftoi Presidentin e Republikës së Kosovës për regjistrim të kërkesës.
14. Më 28 shtator 2018, Zyra e Presidentit dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
15. Më 15 tetor 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që të sqaronte pretendimet e saj në baza kushtetuese.
16. Më 30 tetor 2018, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë përgjigjen e saj.
17. Më 14 maj 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 11 tetor 2010, R. M. nga Prishtina kishte kryer veprën penale të vrasjes, me ç'rast për pasojë kishte mbetur i vrarë A. A. babai i parashtrueses së kërkesës.
19. Më 5 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit PKR. nr. 32/2013, kishte shpallur fajtor R. M. për shkak të veprës penale të vrasjes nga neni 146 i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, neni 328, paragrafi 2 të KPK-së, duke e dënuar me 13 (trembëdhjetë) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim.
20. Më 25 nëntor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 420/2013, pas ankesës së R. M. dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore PKR. nr. 32/2013, të 5 korrikut 2013.
21. Më 5 prill 2018, Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të faljes, i themeluar nga Presidenti i Republikës së Kosovës me Vendimin (Nr. 65/2017), pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve të shumë kërkesave për falje të të dënuarve, hartoi dokumentin duke i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës faljen e disa personave nga vuajtja e dënimit.
22. Më 10 prill 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës, përmes Dekretit për Shpallje të Faljes (DF-2-2018), kishte falur dënimet 14 (katërmbëdhjetë) personave të dënuar. Ndër personat e falur ishte edhe R. M., të cilit i ishin falur 2 (dy) vite nga vuajtja e dënimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Dekreti i Presidentit të cilin e konteston në Gjykatë, është në kundërshtim me Kushtetutën, duke mos specifikuar se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur.

24. Parashtruesja e kërkesës fillimisht pretendon se Dekreti i kontestuar është “ në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës për ligjin për falje. Kushtetuta e Kosovës në ligjin për falje thotë se nuk falet : 1. Vrasja me paramendim, 2 Vrasja e rënd dhe mizore, 3. Ndikimi i faljes nga pala e dëmtuar”.
25. Parashtruesja e kërkesës pretendon se “ Në flet deklarimin për falje nga kryesust e komisionit [R.M] është cilësu se është i akuzum vetëm për një vepër, e kur në realitet aj është i dënuar dhe i akuzuar për dy vepra penale [...] Presidenti e asnjë nga institucionet e tjera të Kosovës nuk morën një vendim të ndihojn familjen time që jemi pala e dëmtuar dhe pa kryefamiljar, pra prej jush kërkojm vetëm drejtësi”.
26. Parashtruesja e kërkesës më tutje thekson se “për shkak të pluhurit të bërë pa dashje nga puna e babait tim unë kam mbetur në moshën 16 vjeçare jetime, dhe Presidenti e asnjë institucion tjetër nuk mori vendim të ndihmojë familjen time që kemi mbetur pa kryefamiljar në moshën 46 vjeçare. [...] E gjithë kjo më bën të mos i besoj drejtësisë në vendin tonë, mjafton që kam mbetur pa baba. Nuk mund të jetoj e qetë kur vrasësi e shijon lirinë e në anën tjetër babai im është i mbuluar me dhe të zi”.
27. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për faljen e R. M., respektivisht se për veprën penale për të cilën ishte dënuar R. M, nuk është e paraparë si vepër penale për të cilën mund të akordohet falja.
28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se dekreti i kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën, me Ligjin nr. 03/L-101 për Falje, duke theksuar: “kërkoj nga ju që me të drejtat e juaja ta shfuqizoni dekretin e datës 11 prill 2018, konkretisht të burgosurin [R. M.] nga Dragashi të mos fitoj dekretin”.

Komentet e dorëzuara nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës

29. Më 28 shtator 2018, Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës kishte dorëzuar në Gjykatë përgjigje në pretendimet e parashtrueses së kërkesës. Në përgjigje, ndër të tjera, theksohet: “Komisioni i themeluar nga Presidenti i Republikës së Kosovës me Vendimin (Nr. 65/2017) [...], pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjeve e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e një (661) kërkesave për falje të të dënuarve, gjatë vitit 2018, në pajtim me Rregulloren (P) Nr. 02/2017 për kriteret dhe procedurat për faljen e personave të dënuar, i ka rekomanduar Presidentit faljen e personave përkatës të përcaktuar në Dekret për shpallje të faljes individuale të datës 16.02.2018 dhe 10.04.2018.[...] Presidenti ka nxjerr Dekretin Nr. DF-02-2018, duke u bazuar në Nenin 84 (29) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenin 8 (1) të Ligjit nr. 03/L-101 për faljen (GZ. nr. 46. 15 janar 2009) dhe rekomandimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për falje, të datës 05.04.2018 [...] Në këtë drejtim, neni 3 i Ligjit nr. 03/L-101 për faljen, Faljen e përcakton si të drejtë të Presidentit, që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jo të rregullt e të rrallë për t'i shpërblyer sjelljet dhe karakteret e jashtëzakonshme ose t'i adresojë shqetësimet e jashtëzakonshme humanitare. [...]

E drejta për të shpallur faljen është e kompetencë ekskluzive e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe nuk mund të transferohet në asnjë autoritet tjetër”.

Dispozitat relevante ligjore

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi nr. 04/L-082)

KAPITULLI XI

FALJA

Neni 112

Falja

“1. Me falje dhe në pajtim me Ligjin për Falje, personave të caktuar emrat e të cilëve saktësohen u jepet lirimi i plotë ose i pjesërishtëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit me një dënim më të butë apo dënimi me kusht ose shlyerja e dënimit.

2. Kryesi nuk mund të falet për çfarëdo dënimi për të cilin Paneli për Lirim me Kusht i ka refuzuar lirimin.

Neni 113

Efekti i faljes në personat e tretë

Me dhënien e faljes nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në dënimin apo aktgjykimin”.

Ligji për Faljen nr. 03/L101

Neni 3

Parimet për Falje

“1. Falja është e drejtë e Presidentit që ka për qëllim përdorimin e një mjeti jo të rregullt e të rrallë për t'i shpërblyer sjelljet dhe karakteret e jashtëzakonshme ose t'i adresojë shqetësimet e jashtëzakonshme humanitare.

2. Presidenti, me falje liron të dënuarin nga të gjitha dënimet që i janë ngarkuar me anë të një vendimi gjyqësor përfundimtar.

Neni 5

Kriteret për Falje

1. Kriteret të cilat shqyrtohen gjatë marrjes së vendimit mbi faljen caktohen nga Presidenti në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin në fuqi.

2. Rrethanat që mund të shqyrtohen gjatë dhënies së faljes përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

2.1. pesha e krimit;

- 2.2. rreziku i recidivizmit;
- 2.3. pendimi i singertë;
- 2.4. shfaqja e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm”.

Pranueshmëria e kërkesës

- 30. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
- 31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

- 32. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës ka kontestuar Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, DF-02-2018, përmes të cilit Presidenti i Republikës së Kosovës akordoi faljen e 14 (katërmëdhjetë) personave, në mesin e të cilëve edhe R. M.
- 33. Gjykata fillimisht vlerëson se në bazë të Kushtetutës, "Individët" (personat fizike dhe juridike), sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës nuk janë të autorizuar që të kontestojë Dekretin e Presidentit në mënyrë abstrakte. Kushtetuta në mënyrë shprehimore parashih palët të cilat janë të autorizuar të kontestojnë Dekretin e Presidentit.
- 34. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se, sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, individët nuk kanë të drejtë t'i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojnë nga e njëjta të vlerësojë kushtetutshmërinë e Dekretit të Presidentit, që pretendohet se është në kundërshtim me Kushtetutën.
- 35. Megjithatë Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se Dekreti i Presidentit si akt i autoritetit publik, ka shkelur të drejtat dhe liritë e saj të mbrojtura me Kushtetutë duke mos i specifikuar se cilat, dhe duke pohuar se për të nuk janë përmbushur kushtet ligjore për faljen e R. M., respektivisht se për veprën penale për të cilën ishte dënuar R. M, nuk është e paraparë si veprë penale.

36. Gjykata konstaton se parashtruesja, kërkesën e saj e ka paraqitur në Gjykatë në përputhje me nenin 113.7 (kërkesë individuale), duke plotësuar edhe formularin standard të Gjykatës për kërkesat individuale.
37. Me këtë rast, Gjykata rikujton se neni 113.7 i Kushtetutës në mënyrë shumë të qartë dhe specifike ka përcaktuar se: *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]"*.
38. Më tutje, Gjykata vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës, paragrafi 3, ku përcaktohet:

*"(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:
[...]
(c) kërkesa nuk është ratione personae në pajtim me Kushtetutën;
[...]"*.
39. Gjykata në rastin konkret, pa vlerësuar natyrën juridike të Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës për falje, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet formale për të shqyrtuar kërkesën në formën në të cilën është paraqitur ajo nga parashtruesja.
40. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se thelbi i kërkesës së parashtrueses ka të bëjë me pretendimin për falje të pjesshme e të paligjshme, të një të dënuari me burgim përmes vendimit të kontestuar, dhe për të cilin parashtruesja e kërkesës, pretendon se nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe Ligjin për Falje.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se individët janë të autorizuar t'i ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë. Veprimi ose mosveprimi duhet ta prekë drejtpërdrejt parashtruesin (*Shih Amuur v. France*, Aktgjykimi në rastin nr. 19776/92, të 25 qershorit 1996).
42. Gjykata përkujton se një ankesë duhet të sillet nga apo në emër të personave që pretendojnë se janë viktimat të shkeljes së dispozitave kushtetuese. Këta persona duhet të jenë në gjendje të tregojnë se janë "prekur drejtpërsëdrejti" nga masa ndaj të cilës ankohen (*Shih rastin Ilhan kundër Turqisë*, kërkesa nr. 22277/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 27 qershorit 2000).
43. Gjykata më tej konstaton se e drejta për falje nga ana e Presidentit, e paraparë me nenin 83, pika (29) të Kushtetutës, është një e drejtë diskrecionale e Presidentit, kushtet dhe rrethanat në të cilat ajo jepet janë të specifikuara me Ligjin për Falje të cilit Gjykata i është referuar më lartë, dhe jo një e drejtë e të dënuarit për kryeje të një vepre penale për të qenë i falur.
44. Pasojat juridike të Dekretit të Presidentit prekin dhe shtrihen vetëm mbi të dënuarit dhe jo mbi personat e tretë.

45. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Kodit Penal të Republikës së Kosovës, respektivisht nenit 113 [Efekti i Faljes të personat e tretë], i cili përcakton: “*Me dhënien e faljes nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në dënimin apo aktgjykimin*”.
46. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se Dekreti i Presidentit nuk iu ka referuar asnjë situatë që prekë të drejtat e ndonjë personi tjetër dhe rrjedhimisht nuk ka mundur të ketë efekte të shkeljeve të supozuara të të drejtave dhe lirive të parashtrueses sepse kishte të bënte vetëm me personat e përcaktuar në Dekret, edhe pse parashtruesja e kërkesës është trashëgimtare e viktimës, A. M., i vrarë nga personi i përfshirë në vendimin e kontestuar. (Shih, *inter alia*, rastet e GJEDNJ-së: *József KÁTAI kundër Hungarisë*, nr. 939/12, Vendim i 18 marsit 2014, paragrafi 25 dhe 26, *TRIVKANOVIC kundër Kroacisë*, nr 12986/13, Aktgjykim 2 i 6 tetorit 2017, paragrafi 49 dhe 51).
47. Gjykata rikujton edhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilën ajo e deklaroi një kërkesë të papranueshme *ratione personae* me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në rastet kur parashtruesi i kërkesës nuk mund të dëshmojë se është viktimë e shkeljeve të të drejtave që pretendon se i janë shkelur. (Shih, *inter alia*, rastet e GJEDNJ-së: *József KÁTAI kundër Hungarisë*, nr. 939/12, Vendim i 18 marsit 2014, paragrafi 25 dhe 26, *TRIVKANOVIC kundër Kroacisë*, nr 12986/13, Aktgjykim 2 i 6 tetorit 2017, paragrafi 49 dhe 51)
48. Bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses është *ratione personae* e papajtueshme me Kushtetutën sepse nuk i ka përmbushur kushtet e parapara me neni 113.7 të Kushtetutës për kërkesat individuale, andaj në përputhje me rregullin 39 (3) (c) të Rregullores së punës shpallet e papranueshme.
49. Duke konstatuar se kërkesa nuk është *ratione personae* e pajtueshme me Kushtetutën, Gjykata nuk e konsideron të arsyeshme të shtjellojë kushtet tjera të pranueshmërisë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (3) (c) të Rregullores së punës, më 14 maj 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi